



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, LEGJISLACIONIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1162 / Prot.

Patos, më 09.04 / 2026

**NJOFTIM**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin “Paketa e Maleve”**

Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës me nr. 1162 prot, datë 01.04.2026 të drejtorisë së Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile për zhvillimin e dëgjesës publike me temë: Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin në “Paketën e Maleve”.

**Ju njoftojmë se:**

Ditën e **Martë** në datë **12.05.2026**, do të organizohen dëgjesat publike me temë: “Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin “Paketa e Maleve” me pjesëmarrje të: anëtarë të Këshillit Bashkiak; kryetarë të fshatrave; banorë të fshatrave; posedues jopronarë të tokave; shoqëri civile; subjekte juridike; qytetarë të Patosit të interesuar për zhvillim; grupe të tjera interesi dhe përfaqësues të bashkisë Patos sipas grafikut më poshtë:

- Ora 09:00 në fshatin **Ruzhdie**;
- Ora 10:00 në fshatin **Gjynoqarë**;
- Ora 11:30 në fshatin **Siqecë**;
- Ora 13:00 në fshatin **Drenic**.

Këto konsultime publike synojnë informimin dhe saktësimin e poseduesve jopronarë të pasurive në zonat me potencial zhvillimi lidhur me aplikimin “Paketa e Maleve”.

Komentet dhe rekomandimet e grupeve të interesit janë të mirëpritura, brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik në adresën e email-it: [info@bashkiapatos.gov.al](mailto:info@bashkiapatos.gov.al).

*Pjesëmarrja juaj në këtë dëgjesë publike është shumë e rëndësishme për garantimin e një procesi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.*



**KRYETARI**  
**Fation Duro**